

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: Furnizim me automjete transporti

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34100000-8 automjete

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 4 630 000 *(katër milion e gjashtëqind e tridhjetë mijë)*, lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shtypshkronja e Letrave me Vlerë SH.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Këto kërkesa mbështeten në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit kërkohet si mjet paraprak për verifikimin e përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, në funksion të zhvillimit të një procedure efikase, të shpejtë dhe të kontrollueshme. Sigurimi i ofertës kërkohet për të garantuar seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e ofertës gjatë periudhës së vlefshmërisë së saj, si dhe për të mbrojtur autoritetin kontraktor nga tërheqja e pajustificuar e ofertës, mosparaqitja e dokumentacionit provues apo refuzimi i nënshkrimit të kontratës nga ofertuesi fitues. Këto kërkesa vlerësohen të nevojshme për garantimin e rregullshmërisë dhe besueshmërisë së procedurës së prokurimit me objekt “Furnizim me automjete transporti”, për nevojat e shoqërisë.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.1.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet çertifikata ISO e kërkuar.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, dhe nenin 79 të Ligjit nr.162/2020, si dhe në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkimi i certifikatës ISO 9001 ose ekuivalente synon të verifikojë se operatori ekonomik ushtron veprimtarinë nëpërmjet një sistemi të menaxhimit të cilësisë, i cili garanton standardizimin e proceseve, kontrollin e furnizimit dhe qëndrueshmërinë e cilësisë së produkteve. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin me automjete transporti, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik të provojë kapacitete organizative dhe procedurale për realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat teknike, cilësore dhe ligjore të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Ky kriter është proporcional me natyrën dhe rëndësinë e kontratës dhe shërben për të garantuar besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit.

**2.1.2** Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet çertifikata e akreditimit përkatëse.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 1, shkronja “a”, nenin 79, pika 2, shkronja “c”, të Ligjit nr.162/2020, si dhe në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Kërkesa që organi i vlerësimit të konformitetit të jetë i akredituar synon të garantojë që certifikatat ISO të paraqitura nga operatori ekonomik janë lëshuar nga subjekte me njohje, besueshmëri institucionale dhe vlefshmëri sipas standardeve të akreditimit të pranuar nga Republika e Shqipërisë, në përputhje edhe me Ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit”. Paraqitja e certifikatës së akreditimit të organit lëshues është e nevojshme për të verifikuar autenticitetin, vlefshmërinë dhe forcën provuese të dokumentacionit të paraqitur në procedurë. Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për të kryer një vlerësim të mbështetur në dokumente të besueshme dhe të verifikueshme, në funksion të përzgjedhjes së një operatori ekonomik të aftë për realizimin e kontratës me objekt “Furnizim me automjete transporti”.

**2.1.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin zyrtar që vërteton të jetë i pajisur me licensë me kodin VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, sipas legjislacionit në fuqi, të lëshuar nga organet kompetente shtetërore.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili ka të bëjë me furnizimin me automjete transporti. Kërkimi që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licensë me kodin VII.3.B.1/d “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, të lëshuar nga organet kompetente shtetërore, synon të verifikojë se ofertuesi ushtron ligjërisht veprimtarinë tregtare që lidhet me shitblerjen e mjeteve me motor dhe rimorkiove, sipas kategorive të licencimit të administruara nga QKB dhe ministria e linjës. QKB e pasqyron këtë kategori licence në regjistrin e saj të leje-licencave si veprimtari të licencuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të sigurohet që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore dhe kapacitetin formal për të realizuar furnizimin me automjete transporti, duke shmangur pjesëmarrjen e subjekteve që nuk ushtrojnë të licencuar këtë veprimtari. Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe i nevojshëm për të garantuar ligjshmërinë, besueshmërinë dhe rregullshmërinë e furnizimit.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Paraqitja e pasqyrave financiare vjetore për 3 vitet e fundit kërkohet për t'i mundësuar autoritetit kontraktor verifikimin e gjendjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorit ekonomik, në funksion të aftësisë së tij për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin me automjete transporti, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të sigurohet që operatori ekonomik ka kapacitet financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës. Kushti që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos rezultojë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është vendosur për të verifikuar një nivel minimal qëndrueshmërie financiare dhe për të shmangur rrezikun e mosrealizimit të kontratës për shkaqe që lidhen me paaftësinë ekonomike të operatorit. Kërkesa për akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar, në rastet e parashikuara nga ligji, vendoset në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më e ulët se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 dhe në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Kërkimi i një xhiroje vjetore jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit synon të verifikojë se operatori ekonomik ka kapacitet financiar dhe aktivitet tregtar të mjaftueshëm për të përballuar realizimin e kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin me automjete transporti, autoriteti kontraktor vlerëson se ky nivel xhiroje është proporcional me natyrën, vlerën dhe rëndësinë e kontratës dhe shërben për të garantuar aftësinë e operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të saj. Kërkesa konsiderohet e ekuilibruar, pasi përmbushja e xhiros minimale kërkohet vetëm në të paktën një vit të periudhës së përcaktuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 20% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 dhe në nenin 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Kërkimi i furnizimeve të ngjashme synon të verifikojë përvojën e mëparshme të operatorit ekonomik në realizimin me sukses të kontratave të krahasueshme për nga natyra dhe vlera. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin me automjete transporti, autoriteti kontraktor vlerëson se përvoja e mëparshme në këtë fushë përbën tregues të rëndësishëm të kapacitetit teknik, organizativ dhe tregtar të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës. Përcaktimi i pragut në masën 20% të vlerës së fondit limit është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konsiderohet proporcional, pasi synon të provojë një nivel minimal përvoje pa kufizuar në mënyrë të pajustificuar konkurrencën. Dokumentacioni i kërkuar shërben për verifikimin objektiv të natyrës, vlerës dhe realizimit me sukses të furnizimeve të mëparshme, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për mallrat objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4, të Ligjit nr.162/2020 dhe në nenin 40, pika 6, shkronja “b”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Paraqitja e katalogëve, fragmenteve të katalogëve ose skedave teknike kërkohet me qëllim verifikimin objektiv dhe të drejtpërdrejtë të përputhshmërisë së automjeteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëpërmjet këtij dokumentacioni, autoriteti kontraktor krijon mundësinë të vlerësojë nëse automjetet e ofertuara përmbushin karakteristikat teknike, funksionale dhe cilësore të kërkuara, pa u mbështetur vetëm në deklarime të përgjithshme të operatorit ekonomik. Ky kriter është i nevojshëm për të garantuar saktësinë dhe krahasueshmërinë e vlerësimit të ofertave dhe konsiderohet proporcional me natyrën e objektit të prokurimit.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 dhe në nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021. Kërkimi i deklaratës së furnizimit ose autorizimit nga prodhuesi/distributori i autorizuar është i nevojshëm për të garantuar origjinën e mallrave, ligjshmërinë e kanalit të furnizimit dhe disponueshmërinë reale të automjeteve objekt prokurimi. Nëpërmjet këtij dokumentacioni, autoriteti kontraktor verifikon se operatori ekonomik ka një burim furnizimi të rregullt, të autorizuar dhe të gjurmueshëm për realizimin e kontratës. Në rastet kur dokumenti paraqitet nga distributori, kërkesa për paraqitjen e aktmarrëveshjes me prodhuesin shërben për të garantuar vlefshmërinë e zinxhirit të furnizimit dhe besueshmërinë e autorizimit. Ky kriter është proporcional me natyrën dhe rëndësinë e kontratës dhe i shërben autoritetit kontraktor për të minimizuar rrezikun e mosfurnizimit ose të furnizimit me mallra që nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues, për të garantuar shërbimet e automjetit gjatë periudhës së garancisë, duhet të ketë minimalisht një servis në pronësi/me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacion si më poshtë:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet. Licenca të jetë e vlefshme.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 dhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, si dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, që ka të bëjë me furnizimin me automjete transporti. Kërkimi që operatori ekonomik të disponojë minimalisht një servis në pronësi, me qira ose sipas formave të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi, synon të garantojë mundësinë reale të ofrimit të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit gjatë periudhës së garancisë. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor verifikon që operatori ekonomik ka kapacitetin teknik dhe infrastrukturën e nevojshme për të siguruar mbështetje pas shitjes, në funksion të ruajtjes së funksionalitetit dhe vijimësisë së përdorimit të automjeteve. Kërkesa për paraqitjen e licencës përkatëse të autoriparimit shërben për të provuar ligjshmërinë e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe përputhshmërinë me kuadrin rregullator në fuqi. Ky kriter është proporcional me natyrën dhe rëndësinë e kontratës dhe i nevojshëm për të garantuar zbatimin e rregullt të detyrimeve të garancisë.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën e Konformitetit (CoC) për automjetin e ofertuar, të lëshuar nga prodhuesi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së kërkesave teknike dhe standardeve të sigurisë të Bashkimit Europian, në përputhje me kërkesat e nenit 4 të Udhëzimit nr.4, datë 28.06.2019 “Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore”, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Rregullores së (BE) 2018/858 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi miratimin dhe mbikëqyrjen e tregut të automjeteve dhe rimorkiove të tyre, si dhe të sistemeve, komponentëve dhe njësive të veçanta teknike të destinuar për automjete të tilla”.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, si dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, që ka të bëjë me furnizimin me automjete transporti. Kërkimi i Çertifikatës së Konformitetit (CoC), të lëshuar nga prodhuesi, synon të verifikojë se automjeti i ofertuar përmbush kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë të zbatueshme, si dhe se disponon dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim dhe regjistrim sipas legjislacionit në fuqi. Nëpërmjet këtij dokumenti, autoriteti kontraktor sigurohet për përputhshmërinë e automjetit me kërkesat e homologimit, identifikimit teknik dhe standardeve të prodhuesit, duke minimizuar rrezikun e furnizimit me automjete që nuk mund të regjistrohen ose nuk përmbushin parametrat e kërkuar ligjorë e teknikë. Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe i nevojshëm për të garantuar furnizimin me automjete të rregullta, të sigurta dhe të përdorshme nga shoqëria.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie për automjetet e ofruara, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë: *“Jo më pak se 3 (tre) vjet ose 100 000 km, kush të plotësohet e para”*. (Garancia të jetë e shoqëruar me përshkrimin e saktë të kushteve dhe mbulimit të garancisë dhe një deklaratë për normën që do të kryhen shërbimet periodike dhe çmimet e zërave të shërbimeve).

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, që ka të bëjë me furnizimin me automjete transporti. Kërkimi i deklaratës së garancisë për një periudhë jo më pak se 3 vjet ose 100 000 km, kush të plotësohet e para, synon të garantojë që automjetet e ofruara mbuloohen me garanci të mjaftueshme për funksionimin normal të tyre dhe për mbrojtjen e autoritetit kontraktor nga defektet ose mosfunksionimet që mund të shfaqen pas furnizimit. Kërkesa që garancia të shoqërohet me përshkrimin e kushteve dhe mbulimit të saj, si dhe me deklarimin e normës së kryerjes së shërbimeve periodike dhe çmimeve përkatëse, është vendosur për të siguruar qartësi mbi detyrimet e ofertuesit gjatë periudhës së garancisë dhe për të mundësuar vlerësimin e kostove dhe kushteve të mirëmbajtjes së automjeteve. Ky kriter është proporcional me objektin dhe rëndësinë e kontratës dhe i nevojshëm për të garantuar përdorshmërinë, mirëmbajtjen dhe vijimësinë e shërbimit të automjeteve të furnizuara.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e automjeteve me të gjithë dokumentacionin përkatës, të detyrueshëm për qarkullim, në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, që ka të bëjë me furnizimin me automjete transporti. Kërkimi i deklaratës me anë të së cilës operatori ekonomik merr përsipër dorëzimin e automjeteve me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm për qarkullim synon të garantojë që automjetet e furnizuara do të jenë të plota nga pikëpamja dokumentare dhe të gatshme për regjistrim e përdorim sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor sigurohet që dorëzimi i automjeteve të mos kufizohet vetëm në aspektin fizik të mallit, por të përfshijë edhe dokumentacionin e nevojshëm për vënien e tyre të rregullt në përdorim. Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe i nevojshëm për të garantuar përdorshmërinë e menjëhershme dhe ligjshmërinë e automjeteve të furnizuara.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

S Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i ngritur me urdhër të Titullarit, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, dhe nenin 36 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe me nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke respektuar gjithashtu kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurinë, vlerësimin e konformitetit dhe tregtimin e produkteve jo-ushqimore.

Specifikimet teknike janë përcaktuar mbi bazën e nevojave reale të shoqërisë dhe në funksion të përdorimit të automjeteve për përmbushjen e detyrave të saj funksionale. Kërkesat e përcaktuara për kategorinë e automjeteve, vitin e prodhimit, llojin e karburantit, cilindratën, fuqinë motorike, përmasat, sistemin e drejtimit, nivelin e emetimit të gazrave, si dhe për elementet e sigurisë, komoditetit dhe pajisjeve ndihmëse, janë vendosur për të garantuar furnizimin me automjete të reja, funksionale, të sigurt dhe të përshtatshme për përdorim të përditshëm institucional.

Parametrat teknikë janë hartuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë një nivel të përshtatshëm performance, sigurie, përdorshmërie dhe jetëgjatësie të automjeteve, duke marrë në konsideratë standardet aktuale të tregut dhe kërkesat për efikasitet në përdorim. Përcaktimi i kërkesave minimale për elemente si standardi i emetimeve Euro 6, sistemi ABS, ESP, AIRBAG, hill start assist, sensorët e parkimit, sistemet e komandimit dhe pajisjet e tjera të nevojshme është bërë për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë që këto elemente kanë me sigurinë, funksionalitetin dhe performancën e automjeteve.

Gjithashtu, kërkesa që automjetet të jenë të reja, të papërdorura dhe të dorëzohen me të gjithë elementët dhe dokumentacionin përkatës, brenda afatit të përcaktuar kontraktor, është vendosur për të garantuar që malli objekt prokurimi të jetë i gatshëm për përdorim, në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore të autoritetit kontraktor. Në këto kushte, specifikimet teknike vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me objektin e prokurimit, nuk krijojnë kufizime të pajustificuara për konkurrencën dhe i shërbejnë drejtpërdrejtë garantimit të furnizimit me automjete transporti të përshtatshme për nevojat e shoqërisë.

*Specifikimet teknike gjenden në Shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*